

Drejtoria Rajonale Tiranë

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __/__/2023

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës -Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje 3(tre) bileta udhëtimi me itinerar Tiranë – Athine -Tiranë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Bileta transporti

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, për procedurën e sipërcituar, si më poshtë:

“Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi me itinerar Tiranë – Athine -Tiranë”.

Përshkrimi, kërkesat dhe mënyra e furnizimit:

- Blerje bileta udhëtimi me avion (klasi ekonomik) vajtje-ardhje me itinerar Tiranë – Athine- Tiranë - copë 3(tre) persona adult.

Të dhëna për biletat e datës 06.06.2023-08.06.2023;

- Data e nisjes nga Tirana për në Athine datë 06.06.2023, me orar nisje nga Tirana pas orës 12:00, dhe kthimi date 08.06.2023 pas orës 18.00;
- Fluturimi në vajtje të jetë direkt (pa tranzit);
- Klasi ekonomik;
- Me bagazhe (20 kg);

I. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike janë hartuar nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht:

- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik";
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar;
- Udhëzimin nr. 03 datë 18.06.2021 "Mbi përdorimin e Sistemit Dinamik për Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar dhe Zhvillimin me Mjete Elektronike"

Argumentimi:

- Deklarata me shkrim se ofertuesi i plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë, *është vendosur me qëllim garantimin e autoritetit kontraktor se ofertuesi do të plotësojë specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara, në funksion të plotësimit të nevojës konkrete objekt prokurimi në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, si dhe të jetë i gatshëm të përgjigjet 24 orë, çdo ditë të javës (përfshirë dhe festat zyrtare), lidhur me problematikat apo rastet e paparashikueshme që mund të dalin.*

I. KRITERET KUALIFIKUESE

Operatori ekonomik duhet të ketë në objektin e aktivitetit të tij tregtar, (Q.K.B.) shitjen e biletave të transportit ajror, mungesa e të cilit përbën shkak për refuzim të ofertës.

Argumentim: Ky kriter është në përputhje me pikën 11 të Udhëzimit nr. 03 datë 18.06.2021 "Mbi përdorimin e Sistemit Dinamik për Blerjen e Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar dhe Zhvillimin me Mjete Elektronike"

-Do të angazhohet me përgjegjësi të lartë për zgjidhjen e problemeve lidhur me vonesat e fluturimeve, humbjen e bagazheve, sendeve të tjera si dhe çdo rast tjetër i paparashikueshëm.

- Për çdo rast udhëtimi, operatori ekonomik duhet të marrë masat e menjëhershme, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, dhe të sigurojë vijimësinë e udhëtimit në destinacion në një kohë sa më të shpejtë nga itinerari fillestar.

Të garantojë përballimin e çdo pasoje të mundshme ekonomike, në raste të jashtëzakonshme, si fatkeqësi natyrore, kushte të këqija të motit, grevë apo falimentim të operatorit, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit, të cilat nuk vijnë si pasojë e veprimit të Autoritetit Kontraktor.

Të garantojë ruajtjen e konfidencialitetit, përsa i takon informacionit të siguruar nga Autoriteti Kontraktor.

- Operatorët Ekonomikë të interesuar që duhet të kenë dhe të paraqesin:

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëare-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softëare-ike.

Argumentim: Në bazë të Njoftimit të Përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. 25366 prot datë 30.12.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 8480 prot datë 30.12.2020.

II. TË TJERA

Me marrjen e njoftimit, Operatori Ekonomik i renditur në vend të parë, duhet ti përgjigjet Autoritetit Kontraktor brenda 2 orëve nga marrja e njoftimit për mos/ realizim të shërbimit.

Në rast të marrjes përsipër të realizimit, brenda 24 orëve, operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentat si më poshtë:

- 1- Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar, me intenerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit, si dhe kodin e llogarisë së klientit.
- 2- Formularin e Ofertës Ekonomike dhe IBAN
- 3- Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Mosparaqitja pranë Autoritetit Kontraktor, ose mos konfirmimi elektronikisht për përmbushjen e shërbimit, sjell skualifikim, dhe proçedurat vazhdojnë me Operatorin Ekonomik të radhës.

Dokumentat duhet të jenë të vlefshme në kohën e dorëzimit, origjinale ose kopje të noterizuara, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Operatori Ekonomik fitues duhet të paraqitet pranë Drejtorise Rajonale e OSSHsh.a Tirane,

Argumentimi: Kriteret e veçanta për kualifikim u hartuan në përputhje me qëllimin e zhvillimit të procedurës dinamike të prokurimit.

Komisioni i Blerjeve te Vogla